



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 8 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2015 për transparencë në Komuna, të nenit 32 pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.05.2016, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR KONSULTA PARAPRAKE PUBLIKE LIDHUR ME RREGULLOREN MBI TAKSAT**  
**ADMINISTRATIVE PËR DHËNIEN E LEJES SË NDËRTIMIT DHE TARIFAT PËR**  
**RREGULLIMIN E INFRASTRUKTURËS**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për dërgimin e Rregullores mbi taksat administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, në konsulta paraprake publike.

**Neni 2**

Komisioni lidhur me vendimin e cekur në pikën 1, do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin – qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatës informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t'i testuar dhe diskutuar propozimet.

**Neni 3**

Konsultat paraprake publike për rregulloren e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të zgjasin për periudhën prej 60 ditësh.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.nr. 035-121656 , më 19.05.2016**



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Halim Halimi, jur.i dipl.**



## Arsyetim

Grupi punues, i formuar me qëllim të hartimit të Rregullores për taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, ka përgatitur projektregulloren, të cilën në pajtim me pikën a të nenit 32 të Statutit të Komunës, po ua dërgojmë për shqyrtim.

Me Rregulloren për taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, do të përcaktohen tarifat, obliguesit, procedura e pagesave dhe procedura e ankesave për taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit, tarifat për ndikimet nga rritja e dendësisë së infrastrukturës, dhe tarifën për ndërtimin e infrastrukturës.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është krijimi i të hyrave vetanake buxhetore të Komunës, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të administratës komunale për planifikimin hapësinor, dhënien e lejes së ndërtimit, ofrimin e inspektimeve të ndërtimit dhe dhënien e certifikatës së përdorimit, si dhe shpenzimeve për ndërtimin, përmirësimin, zgjerimin ose riparimin e infrastrukturës komunale.

Lartësia e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësisë së infrastrukturës, është bërë në harmoni me nenet 22 dhe 23 të Ligjit nr. 04/L-110, për ndërtim, Udhëzimit administrativ nr. 22/2012, mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, i protokolluar më 19.11.2012, me nr. të protokollit 01/3276/12, si dhe në bazë të aneksit 1,2 dhe 5, si pjesë e këtij udhëzimi.

Llogaritja e këtyre dy taksave është bërë nga grupi punues përkatës, me përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, Drejtoria e Financave dhe Pronës dhe përfaqësuesi i Departamentit të Prokurimit Komunal, i formuar me Vendimin 01. nr. 031-25892/1, dt. 26.9.2014 të Kryetarit të Komunës.

Më 29.09.2015, Komuna ka pranuar shkresën me nr. ZSP-1216/15, me anë të së cilës Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, konfirmon se taksat e propozuara dhe mënyra e llogaritjes janë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Tarifa për ndërtimin e infrastrukturës përcaktohet në bazë të shpenzimeve të Komunës së Prishtinës për ndërtimin, riparimin e infrastrukturës dhe ndikimin e infrastrukturës bazë. Lartësia e tarifës për ndërtimin e infrastrukturës, obligimet, afatet dhe mënyrën e realizimit të infrastrukturës, definohen me marrëveshje të veçantë në mes investuesit dhe Drejtorisë përkatëse për Infrastrukturë.

Andaj, në cilësinë e Kryetarit të Komunës, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 58, pika h e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale dhe nenit 52, pika h e Statutit të Komunës, i propozoj Kuvendit të Komunës që, duke u mbështetur në nenin 32, pika c, ta miratojë për diskutim publik projektregulloren për taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Shtojcë:

- Shkresa nr. ZSP-1216/15 e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Shkresa e Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe
- Tabelën e llogaritjes së taksave.